



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



Termt e References

Trajner mbi edukimin mediatik

“Mobile Journalism- From Corners to cities”

Përtej Barrierave është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit joformal. Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus + YIA dhe European Solidarity Corps të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.

Mbi projektin

Kanali i mediave sociale dhe përdorimi i tyre është shumë i përhapur tek të rinjtë, megjithatë mungesa e navigimit të duhur dhe të sigurt të këtyre medimeve është një problem. Një shqetësim tjetër i fushës është se të rinjve nga zonat më të vogla dhe më të largëta u mungojnë informacionet, aftësitë dhe njohuritë konkrete në edukimin mediatik. Nëpërmjet kësaj iniciative, ne kërkojmë t'u ofrojmë atyre një shans të barabartë për të mësuar rreth Edukimit Mediatik dhe për të zhvilluar aftësi konkrete që ata mund të praktikojnë në krijimin e shkrimit të artikujve, podcasting, blogje, foto lajme etj nga telefonat e tyre celularë. Duke i pajisur të rinjtë me aftësi konkrete, ata do të jenë në gjendje të mbrojnë dhe raportojnë shkeljen e të drejtave të njeriut (raportojnë diskriminimin në internet dhe gjuhën e urrejtjes në internet) dhe të njohin lajme të rreme (çrregullim informacioni, foto të rreme, teori konspirative), të raportojnë për problemet në komunitetin e tyre lokal.

Projekti është një kombinim i aktiviteteve kreative duke përfshirë 8 punëtorë mbi Literaturën Mediatike dhe 2 aktivitete trajnimi i cili nxit kompetencat e të rinjve në qytetarinë aktive dhe qytetarinë dixhitale duke përdorur mjetet e mediave sociale për të adresuar dhe raportuar problemet në komunitetet lokale.

Pozicioni: Trajnues për dy trajnime onsite në qytetin e Kukësit dhe Vlorës

Tipi i kontratës: Kontratë shërbimi

Kohëzgjatja: Nentor 2022

Afati i aplikimit: 10.11.2022



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



1. FUSHEVEPRIMI I PUNES

Eksperti do të komunikojë nga afër dhe do të punojë nën mbikëqyrjen e organizatës koordinuese dhe koordinatorit të projektit. Gjatë procesit të trajnimeve trajnuesi do të përcjellë procesin e trajnimit dhe do të kryejë si më poshtë:

Të zhvillojë një orar për të vlerësuar nevojat e trajnimit

Të konsultohet me koordinatoren e projektit

Të ndjekë dhe përpilojë të dhënat e mbledhura nga trajnimet

Të komunikojë nevojat e trajnimit dhe burimet online

Të krijojë strategji trajnimi

Të testojë dhe rishikojë materialet e krijuara në module

2. PROFILI I EKSPERTIT

Kompetencat:

- Ekperienca të mëparshme si trajnerë, lehtësues ose organizatorë në aktivitete në edukimin joformal
- Në gjendje të transferojë njohuritë e fituara gjatë trajnimit në ekipet që kryejnë aktivitete
- Të ketë përvojë të mëparshme me metodologjinë e arsimit joformal (si trajnerë, lehtësues ose pjesëmarrës) dhe motivim për të zhvilluar kompetencat e tyre
- Ndjenjë e lartë përgjegjësie, interes për subjektet e projektit dhe të jetë i përkushtuar;
- Niveli i lartë i aftësive analitike;
- Menaxhues shumë i mire i kohës;
- Aftësi të avancuara në përdorimin e mjeteve të tjera dixhitale (mentimeter, Kahoot etj);
- Një diplomë akademike në një fushat sociale (p.sh. shkenca sociale, gazetari etj) ose përvojë praktike të vërtetuar ekuivalente;

3. PROCEDURA E APLIKIMIT



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet e kërkuara si më poshtë:

- Curriculum Vitae (shqip)
- Letër interesi (shqip)

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 10 Nentor 2022, 23:59, ne adresën e emailit:
silvia.dervishi@beyondbarriers.org

6. PROCEDURA E VLERËSIMIT

Kriteret kryesore të përzgjedhjes do të jenë ekperienca në punën rinore, ekspertiza si trajnues në aktivitete të edukimit jo-formal. Do të njoftoheni për përgjigjen me anë të emailit.